



Tiranë, Maj 2020
ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM

MONITORIMI I BASHKISË TIRANË

NË LIDHJE ME MASAT E NDËRMARRA NË KUADËR TË PANDEMISË COVID – 19

TABELA E PËRMBAJTES

3 SHKURTIME

3 FALENDERIME

4 HYRJE

5 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

7 ANALIZË E GJETJEVE

Raportim bazuar në informacionet e Bashkisë Tiranë
Gjetje nga intervistat cilësore

17 SITUATA E BIZNESEVE

19 REKOMANDIME

20 ANEKSE

Vendimet e Këshillit Bashkiak
Pyetësori që i është dërguar bashkisë

Ky raport është Përgatitur nga Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim" në kuadër të projektit POP 2020 "Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal" të mbështetur nga Olof Palme Centre International, përmes mbështetjes financiare të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Qeverisë Suedeze ose të Olof Palme International Centre.

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për pa-aftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale

Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë mbylljes së pazakontë për shkak të pandemisë COVID-19 bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Tiranë, sidomos Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, për përgjigjen e shpejtë brenda afatit kohor si dhe Këshillin Bashkiak Tiranë, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra gjatë pandemisë COVID-19. Falenderojmë veçanërisht qytetarët që pranuan ti përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë Olof Palme International Center, për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin *"Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)"* në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura. Rrjeti *"Përballja e Ofertave Politike "POP"*, synon të rrisë debatin publik dhe përçojë informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien.

Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: *"Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social"*. Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim", Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorës,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamez;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelktualët e Rinj "Shpresë", Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me *"Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal."* Gjatë fazës së parë të kësaj nisme POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratat Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.

Por, mes situatës së krijuar nga COVID-19, anëtarët e rrjetit POP përshtatën aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit që këto organizata përfaqësojnë.

Gjatë muajve mars dhe prill 2020, organizatat patën si qëllim:

- Të monitorojnë Këshillat Bashkiakë dhe veprimtarinë e bashkive për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojnë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llojnë dhe advokojnë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Metodologjia

Për të realizuar raportin, organizatat anëtare të POP u bazuan në metodat më poshtë.

1. Në çdo bashki u dërgua një letër-kërkesë për informacion. Përgjigjet e kësaj letre janë në pjesën e analizimit të gjetjeve
2. U realizuan disa intervista cilësore me banorë të njësive të ndryshme, të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparëshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioritetëve të Kontratës Sociale.
3. U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
4. U monitoruan vendimet e keshillave bashkiakë në lidhje me masat e vetë bashkisë në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të këshillave bashkiakë.

Përmbledhje Ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Tiranë, të kryer nga Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim" u gjet:

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia:

- Gjatë muajve shkurt dhe mars janë 4245 familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike nga Bashkia Tiranë, ndjekur nga 554 individë përfitues me statusin e jetimit dhe 205 viktima të dhunës në familje;
- 12761 invalidë pune nga të cilët 57% burra dhe 43%ra përfitojnë ndihmë;
- 2452 fëmijë me aftësi të kufizuar nga të cilët 53% djem 47% vajza përfitojnë ndihmë nga bashkia Tiranë;
- 340 familje nga të cilat 229 në zonat urbane dhe 111 në zonat rurale përfitojnë bonus qeraje;
- 2034 burra dhe 612 gra përfitojnë bonus qeraje pas tërmetit të 26 nëntorit 2019;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, bazuar në donacione të njëpasnjëshme nga organizata e fondacione ka mundur ndihma për çdo familje në nevojë të identifikuar në të 24 njësitë administrative nga të cilat përbëhet. Nga kjo ndihmë deri më 9 prill 2020 kanë përfituar në total 6440 familje, të ndara sipas njësive administrative;
- Paketat ushqimore të ndihmës gjatë pandemisë COVID-19, përmbajnë produktet bazë të shportës si: miell, oriz, sheqer, makarona, vaj ushqimor, kripë, salcë domatesh, fasule, detergjent, sapun, dizinfektues, pampers;
- Përmbatja e paketës ka qenë në varësi të donatorit dhe shpërndarja e tyre bëhet bazuar në sasinë dhe në numrin e anëtarëve të familjes;
- Nuk ka ndarje gjimore për shumë nga të dhënat që morëm nga bashkia Tiranë. Kjo na pengon të analizojmë gjetjet nga pikpamja gjimore.
- Ndarja gjimore pasqyrohet për nënkategoritë: a) Invalidë Pune b) Fëmijë me aftësi të kufizuar.
- Nuk ka shtim të pagesave për personat me aftësi të kufizuar si dhe për ata me ndihmë ekonomike gjatë muajit mars 2020.

- Drejtoria e Shërbimeve sociale bashkiake nuk disponon statistika gjinore për të rinjtë e të rejat. Pasi në zbatim të vendimit nr. 236, datë 19.03.2020, të Këshillit të Ministrave *"Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19"*, të rinjtë nuk janë ndër kategoritë e klasifikuara si shtresa në nevojë.
- Gjatë periudhës 10 Mars -10 Prill, janë trajtuar 24 raste të reja të dhunës në familje dhe përveç tyre janë asistuar për plotësimin e nevojave të tyre edhe 25 raste të tjera dhune të cilat janë nën menaxhim dhe kujdes nga muajt e mëparshëm;

Gjetje nga Intervistat cilësore

- Familjet në nevojë të kontaktuar shprehen se kriza COVID-19 e ka bërë edhe më të vështirë mbijetesën e tyre. Pakot ushqimore të shpërndara nga pushteti vendor sipas tyre nuk janë të mjaftueshme dhe periudha e shpërndarjes duhet të jetë më e shpejtë.
- Anëtarët e Komunitetit Rom & Egjiptian paraqiten si kategoria e cila më shumë nga të gjithë po e vuan situatën e pandemisë. Nga hulumtimet e kryera dhe nga intervistat e drejtpërdrejta 1 në 5 familje ka përfutur pako ushqimore, të cilat sipas tyre nuk janë të mjaftueshme.
- Përsa u përket pensionistëve, në përgjithësi pensionet ju shkojnë në shtëpi nga posta qendrore në bashkëpunim me njësitë administrative respektive. Por edhe fqinjët kanë ndihmuar në shumë raste.
- Gratë të cilat punojnë me ditë pranë familjeve të ndryshme për pastrim shtëpie që nga data 9 mars kanë mbetur pa të ardhurat kryesore për të mbajtur familjet, por disa prej tyre informojnë se ndihma ekonomike e dyfishuar ju ka ardhur në ndihmë.
- Një shtresë që po vuan për shkak të pandemisë dhe akoma nuk ka marrë vemendjen e duhur janë gratë punëtore të fasonerive. Asnjë prej 10 grave të intervistuar nuk ka marrë ndihmë apo "pagë lufte", ndërkohë që 3 nga 10 kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe janë në pritje të përgjigjeve nga njësitë administrative përkatëse;
- Personat me aftësi të kufizuar si dhe ata që përfutojnë KEMP nga shteti raportohet se 2 nga 5 kanë përfutur pako ushqimore falas si dhe kempit nuk iu është ndërprerë;
- Shërbimet sociale pranë bashkisë Tiranë, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, lidhur me masat e marra në mbështetje të individëve dhe familje në nevojë përballë emergjencës së COVID-19, ka mundur identifikimin dhe kontaktimin e individëve/familjeve në nevojë;
- Grupet e terrenit të patronazhimit në çdo njësi administrative/lagje, të cilat përbëhen nga stafe punonjësish sociale dhe vullnetarë, kanë përditësuar listat emërore të personave nën patronazhim (deri në datë 9 prill 2020);
- Shërbimet sociale bashkiake, si pjesë e skemave të mbrojtjes sociale, kanë identifikuar 277 individë që kanë statusin e jetimit dhe ashtu si dhe kuadri ligjor përcakton, ata janë trajtuar me prioritet me programet e arsimit, punësimit, strehimit dhe kujdesit social;
- Sipas intervistave të kryera në njësitë administrative urbane, sidmos me prindërit kuptohet se fëmijët nuk kanë hasur vështirësi në ndjekjen e leksioneve, por theksi bie në cilësinë, nxënien dhe frikën për provimet. Frikë kjo e cila ka ndjekur gjatë këtyre dy muajve edhe maurantët dhe nxënësit e klasës së 9-të, për provimet e lirit;
- Ndërsa në zonat rurale një numër shumë i madh i paidentifikuar nxënësish nuk mund ta ndjekin mësimin me aparate smart, por vetëm përmes programeve që jepen në RTSh.

Analizë e gjetjeve

Raportim bazuar në informacionet e Bashkisë Tiranë

Ky raportim është bazuar në përgjigjet që Bashkia Tiranë i ka dhënë pyetësorit të dërguar në datë 6.4.2020. Bashkia Tiranë iu përgjigj pyetësorit brenda afatit kohor të përcaktuar nga ligji.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, përmes njësive administrative, ka realizuar sistemin online për aplikimin për trajtim me ndihmë ekonomike dhe ndihmën për dhunën në familje, fëmijët e dhunuar, strehimin social, apo në strehëza për të moshuarit etj. që jepet përmes shërbimit social shtetëror për Bashkinë Tiranë. Kjo drejtori ka miratuar në muajin shkurt, 2592 familje përfituese në total. Ndërsa për muajin mars 2020 janë miratuar për të marrë ndihmën ekonomike 2583 familje përfituese në total në zonat rurale dhe urbane. Për vitin 2020 gjatë muajve Shkurt dhe Mars numri i përfituesve të ndihmës ekonomike të ndarë sipas kategorive është 5175, ku trendi nga muaji shkurt në muajin mars ka një ndryshim zbritës të ulët me 9 përfitues.

Tabela 1. Të dhëna sipas kategorive, viti 2020

Perfituesit e Ndihmës Ekonomike sipas kategorive	Shkurt	Mars
Familje	2124	2121
Individë me status jetimi	277	277
Individë - viktima trafikimi	5	5
Individë - viktima dhune	104	101
Familje me trinjakë	20	19
Familje me katërnjakë	4	4
Familje me pesënjakë	1	1
Fëmijë të vendosur në familje kujdestare	56	54
Fëmijë me aftësi të kufizuar në familje kujdestare	1	1
Total	2592	2583

Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Familjet janë kategoria që kryeson në numër në lidhje me këtë përfitim, me 4245 familje përfituese në total për muajt shkurt dhe mars, ndjekur nga Individët me statusin e jetimit me 554 përfitues dhe viktimat e dhunës në familje me 205 përfitues për të dy muajt. Siç vihet re edhe nga tabela, statistikën e përfituesve janë pothuajse të njëjta edhe para edhe pas pandemisë COVID-19.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, përmes njësive administrative, kanë shqyrtuar dhe miratuar listën e 24.338 personave me aftësi të kufizuar (PAK), për trajtim në muajin shkurt 2020. Ndërsa për muajin mars, janë miratuar në total 24.288 përfitues PAK.

Tabela 2. Të dhëna sipas njësive administrative/lagjeve në zona urbane viti 2020

Nr. PAK	NJA nr. 1	NJA nr. 2	NJA nr. 3	NJA nr. 4	NJA nr. 5	NJA nr. 6	NJA nr. 7	NJA nr. 8	NJA nr. 9	NJA nr. 10	NJA nr. 11	LAGJ nr. 12	LAGJ nr. 13	LAGJ nr. 14	TOTAL URBAN
SHKURT	1629	2109	1614	2298	2144	2328	1972	1386	1742	753	1851	0	58	0	19884
MARS	1628	2101	1598	2284	2132	2334	1973	1379	1753	757	1839	0	58	0	19836

Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Tabela 3. Të dhëna sipas njësive administrative/lagjeve në zona rurale viti 2020

Nr. PAK	Kashar	Krrabë	Bërzhitë	Zall Bastar	Farkë	Petrelë	Ndroq	Baldushk	Shëngjergj	Vaqarr	Zall Herr	Dajt	Pezë	TOTAL RURAL
SHKURT	1188	123	206	270	421	219	264	200	104	282	358	622	197	4454
MARS	1196	122	206	272	418	220	263	192	104	278	360	625	196	452


Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Në total për muajin Shkurt dhe Mars 2019 në të gjitha njësitë administrative të bashkisë Tiranë edhe për kategorinë e përfituesve PAK megjithë situatën pandemike nuk ka ndryshime domethënëse në trend zbritës apo rritës.

Bazuar në VKM 617 datë 07.09.2006 *"Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës së personave me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore"*, pasyrat e miratuara, nuk janë të ndara për çdo nënkategori në gjini.

Ndarja gjinore pasqyrohet për nënkategoritë: a) Invalidë Pune b) Fëmijë me aftësi të kufizuar.

Figura 1. Të dhëna gjinore për personat PAK



Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Familjet fituese që përfitojnë bonus qeraje janë shpallur në muajin shkurt 2020 me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 4 datë 5.2.2020. Në total janë 340 familje përfituese nga të cilat 229 janë familje që jetojnë në zonat urbane dhe 111 familje jetojnë në zonat rurale. Ndërkohë që nga kjo kategori përfituesish në të gjithë Tiranën 205 janë gra përfituese dhe 135 janë burra. Të detajuara sipas statusit civil dhe të tjera të dhënat statistikore paraqiten si vijon më poshtë:

Tabela 4. Familjet që përfitojnë bonus qeraje


Nr. Familjeve që përfitojnë bonus qeraje	Ndarja gjinore		Statusi Civil				Zona	
	Burra	Gra	Të martuar	Të divorcuar	Të ve	Beqar me Fëmijë	URB	RUR
340	135	205	157	104	22	31	229	111

Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Numri i ndërtesave të shpallura të pabanueshme pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 është 2646 të tilla, dhe po kaq janë edhe familjet që përfitojnë bonusin e qerasë, nga të cilat 612 janë përfituese gra dhe 2034 janë përfitues burra. Për këtë kategori përfituesish nuk disponohet statusi civil. Nga përfituesit e këtij bonusi, 2618 familje përfituese banojnë në zonat urbane dhe 28 në zonat rurale. Statistikat e mësipërme tregojnë numrin total të ndërtesave që janë shpallur totalisht të pabanueshme.

Figura 2. Familjet që përfitojnë bonus qeraje për shkak të tërmetit

Nr. Familjeve që përfitojnë bonus qeraje




Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Ndërkohë që numri i banesave të cilat do të rikonstruktohen si pasojë e tërmetit të 26 nëntorit 2019, janë 5394 të tilla në total, nga të cilat 5044 janë banesa në zonat urbane dhe 350 të tilla ndodhen në zonat rurale.

Figura 3. Banesa për rikonstruktion

Banesa për rikonstruktion



Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Në total Mekanizmi Kombëtar i Referimit pranë bashkisë Tiranë gjatë periudhës 10 Mars – 10 Prill, ka trajtuar 24 raste të reja të dhunës në familje dhe përveç tyre janë asistuar për plotësimin e nevojave të tyre edhe 25 raste të tjera dhunë të cilat janë nën menaxhim dhe kujdes nga muajt e mëparshëm.

Duke krahasuar të dhënat e rasteve të dhunës të pajisur me Urdhër Mbrojtje dhe me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje për periudhën 10 Mars-10 Prill 2020, me vitin e kaluar, trendi ka ardhur në ulje të numrit të rasteve të raportuara të dhunës. Nga të dhënat e gjeneruara në faqen e evidencave statistikore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 10 Mars-10 Prill 2019 janë gjithsej 118 raste dhune në familje që kanë kërkuar të pajisen me Urdhër Mbrojtje, përkatësisht 28 UM dhe 90 UMM. Ndërsa në periudhën 10 Mars-10 Prill 2020 janë paraqitur 48 raste dhune në familje që kanë kërkuar të pajisen me Urdhër Mbrojtje, përkatësisht 5 UM dhe 43 UMM.

Tabela 5. Rastet e Dhunës në Familje të trajtuara nga MKR Tiranë

Nr. Rasteve të trajtuara të dhunës në familje	Ndarja Gjinore		Statusi Civil				Zona	
	Gra	Burra	Të martuar	Të divorcuar	Të ve	Beqare	URB	RUR
24	22	2	17	3	1	1	16	8

Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Në lidhje me masat e marra për komunitetet Rom dhe Egjiptiane, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale informohet me anë të komunikimeve telefonike me çdo ndërlidhës të komuniteteve rome dhe egjiptianëve si dhe punonjës të Njesisë Administrative për nevojat imediate. Duke u bazuar në këto nevoja bashkia e Tiranës ka ndërtuar një kalendar për ndërhyrjen periodike me ushqime në zonat me popullsi rome dhe egjiptiane dhe rezulton se në bazë të kësaj pune janë mbështetur rreth 1000 familje të këtyre pakicave në zona të ndryshme.

Tabela 6. Përfituesit e Komuniteteve Rome & Egjiptiane

Njësia Administrative	Numri i Familjeve përfituese
NJA 1	236
NJA 2	8
NJA 3	52
NJA 4	80
NJA 5	263
NJA 8	100
NJA 9	120
NJA 11	40
NJA 14	45
Petrelë	39
Kashar	17

Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, bazuar në donacione të njëpasnjëshme nga organizata e fondacione ka mundësuar ndihma për çdo familje në nevojë të identifikuar në të 24 njësitë administrative nga të cilat përbëhet. Nga kjo ndihmë deri më 9 prill 2020 kanë përfituar në total 6440 familje, të ndara sipas njësive administrative.

Tabela 7. Numri i familjeve të trajtuara me ndihma nga donacionet në zonat urbane

Nr. Fam te trajtuara	NJA nr. 1	NJA nr. 2	NJA nr. 3	NJA nr. 4	NJA nr. 5	NJA nr. 6	NJA nr. 7	NJA nr. 8	NJA nr. 9	NJA nr. 10	NJA nr. 11	LAGJ nr. 12	LAGJ nr. 13	LAGJ nr. 14	TOTAL URBAN
	138	194	354	1223	186	53	528	479	709	245	109	110	173	42	4543

Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Tabela 8. Numri i familjeve të trajtuara me ndihma nga donacionet në zonat rurale

Nr. Fam te trajtuara	Kashar	Krrabë	Bërzhitë	Zall Bastar	Farkë	Petrelë	Ndroq	Baldushk	Shëngjergj	Vaqarr	Zall Herr	Dajt	Pezë	TOTAL RURAL
	426	375	133	69	93	117	67	16	170	122	66	63	180	1897

Burimi: Drejtoria e Shërbimit Social - Bashkia Tiranë

Paketat ushqimore të ndihmës gjatë pandemisë COVID-19, përmbajnë produktet bazë të shportës si: miell, oriz, sheqer, makarona, vaj ushqimor, kripë, salcë domatesh, fasule, detergjent, sapun, dizinfektues, pampers. Përmbatja e paketës ka qenë në varësi të donatorit dhe shpërndarja e tyre bëhet bazuar në sasi dhe në numrin e anëtarëve të familjes.


Në zbatim të vendimit nr. 236, datë 19.03.2020, të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", të rinjtë nuk janë ndër kategoritë e klasifikuara si shtresa në nevojë, megjithatë, shërbimet sociale bashkiake i kanë trajtuar ata si pjesë e familjeve në nevojë, duke mundësuar sipas kërkesës paketa ushqimore dhe jo-ushqimore falas.

Bazuar në VKM-në e sipërcituar, shërbimet sociale bashkiake nuk disponojnë momentalisht statistikë të gjeneruar për këtë kategori në nivel bashkie apo informacion për të rikthyer.

Gjetje nga intervistat cilësore

Gjatë muajit Prill 2020, janë kryer një sërë intervistash cilësore nga stafi i GADC me banorë të zonave rurale dhe urbane të Bashkisë Tiranë. Pyetjet kishin të bënin në lidhje me situatën ku banorët gjendeshin pas mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19 dhe çfarë kishin përfituar nga zbatimi i masave të qeverisë Shqiptare dhe nga bashkia Tiranë.

Figura 4. Intervistat me qytetarë



Gjatë periudhës kohore 6 -25 prill u intervistuan më shumë se 100 individë dhe subjekte tregtare në 10 njësi administrative të bashkisë Tiranë, përfshirë këtu edhe njësitë administrative të zonave rurale sipas target grupeve më lart.

Në përgjithësi, situata paraqitet e vështirë për personat e komunitetit Rom e Egjiptian, për pensionistët si dhe gratë që jetojnë vetëm si dhe familjet e varfëra.

Përsa u përket pensionistëve, në përgjithësi pensionet ju shkojnë në shtëpi nga posta qendrore në bashkëpunim me njësitë administrative respektive. Përvec dy rasteve në njësitë administrative të qytetit - ku është dashur ndërhyrja e fqinjëve që posta të merrte informacionin e saktë të tyre për të shpërndarë pensionet pranë banesës.

Asnjë nga pensionistët e intervistuar nuk kishte marrë pako ushqimore. Gjithashtu ata raportojnë se asnjë person nga bashkia, qoftë nëpunës/vullnetar apo administrator i pallateve nuk ju ka shkuar në shtëpi për ti pyetur për nevojat e tyre apo për të ndihmuar për të bërë blerjet ushqimore. Të gjithë pa përjashtim ndihmohen nga familjarët që i kanë afër, nga fqinjët ose disa prej tyre dalin vetë në mëngjes shpejt dhe i kryejnë blerjet. Sidoqoftë numri i pensionistëve të intervistuar është i vogël krahasimisht me numrin e madh të tyre në Bashkinë Tiranë.

Anëtarët e Komunitetit Rom & Egjiptian paraqiten si kategoria e cila më shumë nga të gjithë po e vuan situatën e pandemisë. Nga hulumtimet e kryera dhe nga intervistat e drejtpërdrejta 1 në 5 familje ka përfutur pako ushqimore, të cilat sipas tyre nuk janë të mjaftueshme. Anëtarë të këtij komuniteti të cilët burimin e vetëm të të ardhurave e kanë nga mbledhja e bidonave plastikë dhe kanaçeve të aluminit, e kanë thyer rregullin e karantinimit që në fillimet e pandemisë, duke kontrolluar çdo ditë në koshat e mbetjeve të lagjeve respektive.

Gratë të cilat punojnë me ditë pranë familjeve të ndryshme për pastrim shtëpie që nga data 9 mars kanë mbetur pa të ardhurat kryesore për të mbajtur familjet, por disa prej tyre informojnë se ndihma ekonomike e dyfishuar ju ka ardhur në ndihmë.

Shumë prej anëtarëve të këtyre komuniteteve nuk kanë marrë shërbimin e duhur nga njësi të ndryshme administrative kur janë afruar për të aplikuar për ndihmë ekonomike, duke sjellë kështu revoltim të tyre kundrejt nëpunësve.

"Edhe para virusit, të ardhurat e vetme i kishim nga mbledhja e bidonave dhe kanoçeve nëpër rrugë e kosha plehrash. Nuk kemi ndihmë financiare nga bashkia apo nga shteti. Gruaja ime pas shpalljes së pandemisë COVID-19 ka shkuar 3 herë pranë njësisë administrative nr.4 për tu regjistruar për ndihmë ekonomike, por nuk i kanë zgjidhur punë. Çdo herë e kanë këshilluar të rikthehet. Ka marrë pako ushqimore një herë në dy javë. Shtëpinë e kemi në gjendje të keqe dhe pa çati, por nuk e di se ku të drejtohem për ndihmë. Edhe gjatë kohës së izolimit kemi dalë çdo ditë për të bërë mbledhjen e zakonshme të plastikës dhe aluminit, megjithëse me frikën e ndalimit nga policia".

- Çift rom nga njësia administrative nr. 4.

Familjet në nevojë të kontaktuar shprehen se situata pandemike e ka bërë edhe më të vështirë mbijetesën e tyre. Pakot ushqimore të shpërndara nga pushteti vendor sipas tyre nuk janë të mjaftueshme dhe periudha e shpërndarjes duhet të jetë më e shpeshtë. Nga 1 në 6 familje të kontaktuara pranojnë të kenë marrë në kohë ndihmën ekonomike edhe të dyfishuar, ndërkohë që ka familje të cilat nuk janë fituese në listën e përfituesve të miratuar në muajin shkurt 2020.

Gratë punonjëse të fasonerive në Tiranë janë hallka tjetër e zinxhirit të dobët të pamundësisë për të ushqyer familjet në këtë kohë pandemie. Shumë prej të intervistuarave e kanë humbur punën për shkak të mbylljes së fabrikës dhe nuk janë paguar për asnjë ditë qendrimi në shtëpi. Ndërkohë gratë që aktualisht janë në punë, raportojnë se stafi është ulur ndjeshëm dhe frika e infektimit është prezente sa herë që dalin dhe kthehen në shtëpi. Asnjë prej 10 grave të intervistuar nuk ka marrë ndihmë apo "pagë lufte", ndërkohë që 3 nga 10 kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe janë në pritje të përgjigjeve nga njësiti administrative përkatëse.

"Jam paguar vetëm për 9 ditë pune për muajin mars sepse fabrika u mbyll se nuk plotësonte kushtet. Nuk na kanë njoftuar se kur mund të rihapet dhe unë kam tre gojë për të ushqyer në shtëpi. Nuk kemi asnjë informacion nëse pronarët do të na rikthejnë më në punë apo nëse shteti do të na japë pagën e luftës. Po mbijetoj me borxhe dhe me blerje ushqimore me listë tek dyqani i lagjes."

Grua nga njësia administrative nr. 11

Personat me aftësi të kufizuar si dhe ata që përfitojnë KEMP nga shteti raportohet se 2 nga 5 kanë përfituar pako ushqimore falas si dhe kempit nuk iu është ndërprerë. Ndërkohë që familjarët e personave të tjerë me aftësi të kufizuar përveç kempit të marrë në kohë nuk kanë patur ndihmë tjetër.



"Unë jetoj vetëm me gruan e paralizuar sepse fëmijët i kam jashtë Shqipërisë. Nuk kemi patur asnjë vizitë nga Bashkia apo njësia administrative, për pensionin, qoftë për ilaçet apo për pazaret ushqimore. Në fillim i kreu vetë këto lëvizje, dhe më pas me ndihmën e fqinjëve. Kemi një ndihmëse që kujdeset për gruan e paralizuar, por pengimi i lëvizjes pas orës 13:00 e ka paralizuar sepse, ndihmësja duhet të largohet që në orën 12:00 që të arrijë orarin në shtëpinë e saj. Por për shkak të orarit dhe kufizimeve, ndihmësja nuk është kthyer më sepse ka gjetur punë afër vend-banimit të saj.

Pensionist, njësia administrative nr. 5.

Sipas të dhënave zyrtare të përfituara nga Bashkia e Tiranës, Shërbimet sociale pranë bashkisë Tiranë, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, lidhur me masat e marra në mbështetje të individëve dhe familje në nevojë përballë emergjencës së COVID-19, ka mundur identifikimin dhe kontaktimin e individëve/familjeve në nevojë.

Grupet e terrenit të patronazhimit në çdo njësi administrative/lagje, të cilat përbëhen nga stafe punonjësish sociale dhe vullnetarë, kanë përditësuar listat emërore të personave nën patronazhim (deri në datë 9 prill 2020). Nga fillimi i pandemisë deri në datë 9.4.2020 këto grupe mbështesin dhe kujdesen për 6440 individë/familje në nevojë, numër që vjen në rritje, ndër të cilët aktualisht 2237 janë të moshuar të vetmuar.

Kjo kategori përfiton shërbimet vijuese:

- Paketa ushqimore dhe jo-ushqimore falas për të moshuarit në nevojë;
- Shërbim në banesë për përkujdesje dhe blerje të ushqimeve apo medikamenteve;
- Shërbim "katering" në banesë, pra një vakt i ngrohtë, për të moshuarit e vetmuar e të pamundur që të kujdesen për veten;
- Këshillim e përkujdes psiko-social për të përballuar këtë situatë.

Shërbimet sociale bashkiake, si pjesë e skemave të mbrojtjes sociale, kanë identifikuar 277 individë që kanë statusin e jetimit dhe ashtu si dhe kuadri ligjor përcakton, ata janë trajtuar me prioritet me programet e arsimit, punësimit, strehimit dhe kujdesit social. Sipas vlerësimit të nevojave të tyre përgjatë pandemisë ata janë trajtuar me paketa ushqimore. Ndër ta, 65 individë janë trajtuar me paketa ushqimore falas dhe 9 individë të kësaj kategorie, kanë nevojë për patronazhim në banesë ku u mundësohet sipas kërkesës:

- Paketa ushqimore dhe jo-ushqimore falas;
- Shërbim në banesë për përkujdesje dhe blerje të ushqimeve apo medikamenteve; Shërbim katering në banesë, pra një vakt i ngrohtë, për të pamundur që të kujdesen për veten.
- Këshillim e përkujdes psiko-social për të përballuar këtë situatë.

Në zbatim të vendimit nr. 236, datë 19.03.2020, të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", vajzat nëna nuk janë ndër kategoritë e klasifikuara si shtresa në nevojë për t'u trajtuar përgjatë pandemisë, megjithatë shërbimet sociale bashkiake i kanë trajtuar ato si familje në nevojë, duke mundur sipas kërkesës paketa ushqimore dhe joushqimore falas. Bazuar në VKM e sipër përmendur, shërbimet sociale bashkiake nuk disponojnë statistike të gjeneruar për këtë kategori në nivel bashkie.

Bashkia Tiranë, për të gjithë individët/familjet e identifikuar në nevojë për mbështetje gjatë pandemisë, grupet e patronazhimit në çdo njësi administrative/lagje, i përbërë nga stafi i njësisë, ndërlihdës me komunitetin por edhe vullnetarë, mbajnë kontakt të vazhdueshëm telefonik me përfituesit, por kryejnë edhe vizita në banesë për të mundësuar shërbimet e kërkuara. Lidhur me ata individë/familje që kontaktimi apo/dhe asistimi nuk ka qenë i mundur nga stafet e njësive administrative apo/dhe lagjeve, janë mbledhur raportime në koordinim me kanalet e komunikimit zyrtar të Bashkisë Tiranë si:

- Numri i Gjellbër: 0800 0888
- Adresa e-mailit info@tirana.al
- Aplikacioni "Tirana Ime"
- Posta e Kryetarit të bashkisë
- Platforma e Bashkëqeverisjes

Por edhe nga kanalet jo zyrtare si: rrjetet sociale, OJF-të që operojnë në territorin e bashkisë Tiranë, qytetarë. Kërkesa këto që janë referuar më pas drejt njësive administrative/lagjeve për vlerësim dhe trajtim.

Një kategori tjetër që u pyet përmes intervistave ishin nxënësit e shkollës 9 -vjeçare dhe të mesme, për të parë se çfarë ndodh me mësimin e tyre online si dhe me studentët. Në Tiranën urbane nuk dihet numri i saktë i fëmijëve të pajisur me telefona 'smart' të cilët i përdorin për kryerjen e mësimave, megjithatë mendohet të jetë një numër i konsiderueshëm, por ka edhe fëmijë të cilët nuk i kanë këto pajisje dhe përdorin telefonat e prindërve. Ndërkohë që numri i nxënësve me laptop apo kompjuter personal është i vogël. Situata paraqitet krejt e kundërta në zonat rurale dhe në familjet në nevojë, ku ndjekja e mësimin në kohë reale me anë të programe të ndryshme si What's up, zoom apo class dojo është i pamundur për mungesë interneti dhe pajisjesh. Ndaj për këtë kategori nxënësish, zgjidhje ka mbetur mësimdhënia në Televizionin Shqiptar sipas orareve, programeve dhe klasave.

Mësimdhënia në Televizionin Shqiptar është ndjekur pothuajse nga të gjithë nxënësit në fillimet e tij, por më pas, nxënësit që kanë mundësi komunikimi të drejtpërdrejtë me mësuesit kanë preferuar që të shfrytëzojnë këtë mundësi dhe kanë anashkaluar ndjekjen në televizor.

Edhe studentët e ndjekin mësimin online, por më së shumti nëpërmjet platformave si google classroom, Zoom apo Extalks. Sipas intervistave të kryera në njësitë administrative urbane nuk kanë hasur vështirësi në ndjekjen e leksioneve, por theksi bie në cilësinë, nxënien dhe frikën për provimet. Frikë kjo e cila ka ndjekur gjatë këtyre dy muajve edhe maturantët dhe nxënësit e klasës së 9-të, për provimet e lirim.

Sipas monitorimit dhe raportimit nga Qendresa Qytetare rreth 40.9% e studentëve nuk kanë pasur akses të vazhdueshëm në internet gjatë izolimit nga COVID-19. Vetëm 17% e studentëve që banojnë me qera kanë arritur një marrëveshje me qiradhënësin, 83% kanë paguar qiranë normalisht ose janë në dilemë si do veprojnë. 6 nga 9 universitetet e vlerësuar rezultojnë ngelëse në qasjen ndaj mësimin online.¹

Nga ana tjetër, prindërit shfaqen të shqetësuar më cilësinë e nxënies së mësimave nga fëmijët dhe paralelisht edhe me ngarkesën që fëmijët kanë, sidomos në rastet kur mungojnë mjetet teknologjike për ti ndjekur.

¹ <http://qq.com.al/index.php/2020/04/20/lajmi-vleresimi-i-situates-se-arsimit-te-larte-nen-ndikimin-e-covid19-2/?fbclid=IwAR1GWRL-oHmXSnCxLhB-AXluZjkyO-JiE-eykROBCahzwLwBYaBmB3dbMAI>

Por sipas Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mësimi on-line ka qenë rezultativ dhe përmbush pritshmëritë në këto kohë izolimi. Kalimi nga shkolla te mësimi në kushte shtëpie, gjatë dy javëve të para është pritur mirë nga nxënësit dhe prindërit. Rreth 86.4% e nxënësve shprehen se janë dakord dhe shumë dakord për të marrë mësimet përmes komunikimit online dhe 90.2% e prindërve shprehen dakord dhe shumë dakord që janë pjesë e grupeve të komunikimit online me mësuesit. Mësimi online në kushtet e shtëpisë, me gjithë mbingarkesën e prindërve, ka forcuar më shumë partneritetin nxënës - prindër - mësues duke i dhënë më shumë mundësi prindërve të marrin pjesë në procesin e të nxënës të fëmijëve të tyre.²

"Vajza ime është në klasë të 8-të dhe prej tre javësh përveç mësimet me anë të videove dhe leksioneve në ehat's up kanë vijuar me mësim në kohë reale në platform Zoom. Duke qenë se kjo platformë përdoret gjerësisht në Shqipëri dhe jashtë saj, shpesh ka shkëputje të vazhdueshme dhe mësimi merret me copa. Vajza nuk është e kënaqur me çfarë ka mësuar deri më tani dhe pritshmëritë për rezultatet e fundvitit i kanë rënë ndjeshëm. Frika e saj më e madhe që po i kalon edhe në stres është klasa e 9-të dhe mundësia e saj për të kapur siç duket mësimet dhe nxënien për provimet e lirimet."

Prind, njësi administrative nr.3

"Tre fëmijët e mi e ndjekin mësimin në TVSH sepse nuk kemi telefona me internet dhe as kompjutera. Disa herë na janë shkëputur dritat, por në përgjithësi fëmijët i kanë ndjekur rregullisht mësimet. Nuk e di se si do të veprohet për vlerësimin e tyre."

Prind, njësi administrative Farkë

Situata e bizneseve

Në mënyrë që të kishim një panoramë të qartë dhe duke ditur rëndësinë e madhe të biznesve për punësimin e qytetarëve pyetëm dhe ndoqëm edhe paketat qeveritare në lidhje me ta.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 254 datë 27.3.2020³ "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e COVID-19 , pritët të përfitojnë 123,871 qytetarë, me efekte financiar mbi 5,8 miliardë lekë, në tre muaj. Po ashtu do të përfitojnë rreth 60 mijë të punësuar e vetëpunësuar në biznese të vegjël me xhiro 0-14 milionë lekë ne vit, përfitojnë pagë 26 mijë lekë/muaj. Një tjetër kategori që përfiton është edhe ata të punësuar, të cilët kanë deklaruar pagë 0, që janë rreth 30 mijë persona, që do të marrin 26 mijë lekë/muaj.

² <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Sondazhi-i-m%C3%ABsimit-online-11581.pdf>

³ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/53/55eaab99-6416-4eae-90f4-f43316bee55a>

Ndërkohë rreth 70 mijë familje në ndihmë ekonomike, përfitojnë dyfishin e pagesës aktuale të ndihmës ekonomike si dhe 2,700 individë me pagesë papunësie, përfitojnë dyfishin e pagesës aktuale të papunësisë.

Tirana mban numrin më të lartë të aplikimeve dhe miratimeve nga 4,174 aplikime deri në datë 6.4.2020 ishin paguar 3726 të tilla dhe 448 ishin në proces verifikimi.⁴

Qeveria Shqiptare ka marrë dy herë vendime të rëndësishme në lidhje me rimbursimin e punonjësve të bizneseve që u mbyllën. Vendimi i dytë nr.305 datë 16.4.2020⁵ *"Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e covid-19"*, parashikonte ndihmë për kategoritë vijuese:

- Të punësuarit e subjekteve me të ardhura vjetore mbi 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, të mbyllura sipas Urdhrit/ave të MSHMS, të cilët kanë qenë në punë në datën e hyrjes në fuqi të Urdhrit/ urdhrave të MSHMS, përfitojnë ndihmë financiare prej 40.000 (dyzetëmijë) lekë.
- Të punësuarit e subjekteve të lejuar për të ushtruar aktivitet, të cilët janë larguar nga puna nga data e hyrjes në fuqi të Urdhrit/urdrave të MSHMS deri në datën 10 Prill 2020, përfitojnë ndihmë financiare prej 40.000 (dyzetëmijë) lekë.
- Të punësuarit e subjekteve me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 lekë, të lejuara për të ushtruar aktivitet sipas urdhrit/ave të MSHMS, të cilët kanë qenë në punë në datën e hyrjes në fuqi të Urdhrit/ave të MSHMS, përfitojnë ndihmë financiare prej 40.000 (dyzetëmijë) lekë.
- Të punësuarit e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorin e strukturave akomoduese, të cilët figurojnë në listepagesat e subjekteve, deri në datën e Urdhrit/ave të MSHMS, përfitojnë ndihmë financiare prej 40.000 (dyzetëmijë) lekë. Nëse subjekti ushtron disa lloje aktivitete, përfitojnë vetëm të punësuarit në aktivitetin e strukturës akomoduese.

Sipas monitorimit të kryer nga GADC që nga momenti i miratimit nga KM i paketës së parë dhe asaj të dytë financiare ndihmë, një pjesë e mirë e bizneseve të vogla kanë arritur të përfitojnë "pagën e luftës" sidomos pas publikimit dhe vendimit të pakesës së parë në datë 27.3.2020.

Këto biznese janë kryesisht bar-kafe, parukeri, dyqane të vogla veshjesh si dhe studio dentare të vogla të cilat duket sikur kanë përfituar nga ky vendim i qeverisë, por nga ana tjetër ka edhe shumë biznese të tjera të ashtuquajtura të vogla të cilave kjo ndihmë financiare iu është refuzuar.

Dyqane kompjuterash, rrobaqepësi, dyqane material ndërtimi, qyqane rrobash të përdorura, dyqane lulesh dhe kancelari, raportojnë që megjithëse kanë aplikuar për ndihmë financiare nuk kanë arritur të përfitojnë. Sipas të intervistuarve këto aplikime i kanë bërë nëpërmjet ekonomisteve që iu bëjnë edhe deklaratimet e taksave, por kanë marrë përgjigje negative.

4 <https://gazetamapo.al/rama-jep-shifrat-ja-sa-punonjes-dhe-biznese-kane-perfituar-nga-paga-e-luftes/>

5 <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/67/b8b9f701-ab41-4e23-bc90-e7e445e75308>

Nga ana tjetër, në kuadër të monitorimit kemi hasur shumë biznese të vogla të cilat nga pamundësia e ushqyerjes së familjes kanë punuar në mënyrë të fshehtë me qepena të mbyllur, më së shumti rrobaqepësi, dyqane kompjuterash dhe kancelaritë. E njëjtë ka qenë për dyqanet e materialeve të ndërtimit të cilat kanë gjetur zgjidhjen duke punuar me porosi dërguese me anë të telefonit sipas kërkesës së klientëve.

Por si ka funksionuar pagesa e qerasë për këto biznese të cilat nuk është e lejueshme të kryhet aktiviteti? Sipas intervistimeve të kryera në terren, një pjesë e mirë e pronarëve janë dakortësuar për pagesat sipas vendimit të dalë nga qeveria për lehtësimin e qeramarrësve, por një pjesë realtivisht të ndjeshme zënë edhe ata qiradhënës të cilët nuk e kanë pranuar këtë mënyrë pagese (pas muajit maj) dhe kanë ndërprerë marrëdhëniet me qeramarrësit.

Rekomandime

- Duke qenë se Pandemia COVID-19 është një fatkeqësi e një natyre e veçantë, presim nga Bashkia Tiranë të krijojë një protokoll për këto raste të replikueshëm për bashkitë e tjera dhe që mund të përdoret në raste të ngjashme.
- Bashkia Tiranë duhet të aktivizojë të gjithë administratorët lokalë dhe stafet e tyre të identifikojnë dhe krijojnë në database për familjet dhe individët në nevojë.
- Mbledhja e të dhënave dhe ndarja e tyre gjinore është një domosdoshmëri që bashkia Tiranë duhet ta ketë në vëmendje dhe jo vetëm gjatë situatës pandemike.
- Në raste të tilla ku mijëra familje rrezikohen nga varfëria, duhet të rishikohet buxheti për të ndihmuar këto familje e sidomos kategoritë të cilat nuk janë parashikuara në VKM-të e mëparshme për ndihmë të shtresave në nevojë.
- Identifikimi i kryefamiljareve, punonjëse të sektorëve si fasoneri, që kanë humbur punën dhe asistencë e tyre me ndihmë ekonomike deri në momentin e rifillimit të punës.
- Me anë të administratorëve të blloqeve të pallateve të merren masa për afishimin e mënyrave të kontaktit të bashkisë Tiranë për çdo problematikë nga grupet në nevojë apo pensionistët.
- Një plan i detajuar për ndihmën e komuniteteve Rom & Egjiptiane, sidomos për ato familje të cilat nuk kanë asnjë mundësi jetese përveç mbledhjes së plastikës dhe aluminit.
- Krijimi i mundësisë së bonusit të qerasë për të gjitha viktimat e dhunës në familje kur nuk janë mundësitë për ti akomoduar në Strehëzën Kombëtare.
- Forcimi i MKR-së dhe drejtimi i tyre për të qenë sa më aktivë dhe funksionalë në mbështetje të viktimave të dhunës në familje dhe asaj gjinore.
- Lobimi në qeverinë qendrore për përfshirjen në VKM-të respektive të ndihmës edhe për target grupet si të rinjtë apo vajzat nëna.
- Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm që edhe fëmijët e zonave rurale dhe ato të familjeve në nevojë të mund të pajisen me telefona smart, të cilat mund t'ua lehtësojnë mësimnxënien.

Vendimet e Këshillit Bashkiak

Këshilli Bashkiak Tiranë që nga periudha e shpalljes së Pandemisë COVID-19 dhe pas infektiveve të para në Shqipëri në datë 9 Mars, është mbledhur vetëm një herë në datë 24.3.2020⁶.

1. Në kuadër të marrjes së masave për lehtësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni COVID -19, për t'iu dhënë mundësinë të qëndrojnë në shtëpi dhe të mos humbasin afatet e aplikimit nga programet sociale të ofruar nga Bashkia Tiranë:

- a) Të shtyjë afatin e aplikimit të muajit Mars të fazës së parë për programin social të strehimit "Subvecioni i qirasë", deri në datën 10 prill 2020.
- b) Të shtyjë afatin e aplikimit për të përfituar nga programi "Subvencionimi i interesave të kredisë" deri në datën 17 Maj 2020.

2. Lehtësimin e barrës fiskale për biznesin, duke vendosur:

- a) Përfshirjen nga pagesa e shfrytëzimit të tarifës së zënies të hapsirës publike për muajin Mars-Prill 2020.
- b) Shtyrjen e afatit të këstit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore, nga muaji Prill për në fund të muajit Qershor 2020.
- c) Shtyrjen e afatit të këstit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore të muajit Qershor për në fund të muajit Gusht 2020.

6 <https://dpttv.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/VKB-24.03.2020.pdf>

Pyetësori që i është dërguar bashkisë

Nr. 1. Prot

Tiranë, 6.4.2020

KËRKESË PËR INFORMACION Bazuar në Ligjin Nr.119/2014, "Për të Drejten e Informimit"

Drejtuar: Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë

Lënda: Kërkesë për Informacion në lidhje me masat e marra për popullsinë në zonat rurale dhe urbane të Bashkisë Tiranë në situatën e pandemisë COVID- 19.

I nderuar Z. Veliaj

Uroj të jeni mirë me shëndet e punë. Ju ndjekim vazhdimisht në punën tuaj të përditshme dhe ju përgëzojmë për gjithshëka jeni duke bërë për Bashkinë tonë në përgjithësi e në këtë periudhë të vështirë të pandemisë për shkak të COVID-19.

Duke marrë parasysh situatën aspak të zakonitë që bota në përgjithësi dhe Shqipëria në veçanti po kalon prej pandemisë COVID-19, organizatat e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP), të krijuar gjatë zgjedhjeve Parlamentare 2013 janë duke monitoruar situatën e qasjes së pushtetit vendor pranë komunitetit në 9 bashki të vendit⁷ si dhe mbledhjet e Këshillave Bashkiakë dhe vendimet e tyre.

Bashkia e Tiranës monitorohet nga Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim (GADC).

Me masat e marra nga qeveria shqiptare në lidhje me përballimin sa më të mirë të kësaj situatë, një zë të veçantë ka edhe mbështetja për komunitetin dhe grupet në nevojë, qoftë kjo mbështetje ekonomiko - financiare, shëndetësore apo sociale. Në këtë kuadër, ne do të përgatisim në fillim të muajit maj 2020 një raport i cili do të përfshijë hapat e marra nga bashkia për zbatimin e vendimeve të Qeverisë Shqiptare dhe rekomandime nga ne për shërbimet e ofruara.

Bazuar në këto masa dhe në zbatimin e tyre pranë komunitetit të Bashkisë Tiranë do ju luteshim të na informoni bazuar në pyetjet e mëposhtme:

- Ju lutem na vini në dispozicion vendimet e Këshillit Bashkiak pas datës 9 Mars 2020.
- Sa familje në zonat rurale e urbane janë trajtuar me Ndihmë Ekonomike në Tiranë gjatë muajit shkurt? A ka patur ndryshime në shtimin e rasteve të familjeve me ndihmë ekonomike pas datës 9 Mars dhe sa është numri i përfituesve? A e keni informacionin të ndarë sipas gjinisë që familjet dhe individët e trajtuar nga bashkia juaj, janë identifikuar në territor me probleme të tjera si p.sh. familje me persona me aftësi të kufizuar, fëmijë me autizëm apo tjetër.

- Sa persona, të ndarë sipas gjinisë dhe zonës rurale apo urbane trajtohen me pagesën e paaftësisë për punë (KEMP) të dalë nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMACP) të invalidëve. A ka patur shtim të tyre pas datës 9 Mars 2020? Në rastet kur kohëzgjatja e KMACP ka përfunduar në këtë periudhë dhe kërkon ribërjen e dokumentave nga e para si është vepruar, a e ka penalizuar në vazhdimin e dhënies së pagesave për këtë kategori? A e keni informacionin të ndarë sipas gjinisë, nëse po sa burra e gra janë?
- Sa familje në zonat rurale e urbane, përfitojnë përfitim bonus qeraje? A është shtuar numri i tyre pas datës 9 Mars 2020?
- Sa familje në zonat rurale e urbane kanë mbetur të pastrehë pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019? Sa prej kësaj kategorie marrin bonus qeraje?
- A keni patur e trajtuar raste të dhunës në familje gjatë muajit mars dhe këtë fillim prilli 2020? Nëse po sa raste keni patur? Si është trendi i kësaj periudhe krahasuar me një vit më parë?
- Cilat janë masat e marra për komunitetin Rom dhe Egjiptian pas datës 9 Mars 2020? Sa është numri i familjeve Rome e Egjiptiane, ku janë vendosur ata në Bashkinë Tiranë dhe kush janë përfitimet që ata marrin nga Bashkia.
- Pas vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga Qeveria Shqiptare shoqëruar me izolim të detyrueshëm, a keni identifikuar persona të moshës së tretë që jetojnë vetëm dhe i kanë fëmijët jashtë vendit? Sa është numri i tyre i ndarë sipas gjinisë? Cilat janë masat që ka marrë Bashkia Tiranë për këtë kategori?
- Sa është numri i individëve me statusin e jetimit të ndarë sipas gjinisë, që jetojnë në Tiranë? A po marrin trajtim të veçantë nga Bashkia? Nëse po, cilat janë masat e ndërmarra?
- Sa vajza nëna ka në Tiranë? Në cilat njësi administrative janë të vendosura? A po marrin trajtim të veçantë nga bashkia? Nëse Po, cilat janë masat e ndërmarra?
- Gjatë identifikimit në territor me grupet e punës a keni ofruar ndihmë për individët e papunë, sa nga keta janë burra dhe sa gra dhe cila është ndihma e ofruar? Keni informacion sa është shtuar numri i tyre pas vendosjes së izolimit/vetëkarantimit prej situatës COVID-19. A keni bërë një projeksion të papunësisë?
- Në sa familje keni dërguar ndihma dhe në cilat zona e fshatra? Sa është rritur numri i familjeve që kanë nevojë për ndihma pas datës 9 Mars, 2020. Çfarë përmbajnë këto ndihma? Sa është sasia normale për një familje dhe si dhe sa here bëhet shpërndarja e tyre?
- A ka patur ndryshim të buxhetit të Bashkisë Tiranë pas vendosjes së masave të marra për situatën COVID-19. Nëse jo, si po përballohet kjo situatë nga Bashkia dhe nëse po si dhe ku janë reflektuar këto ndryshime?
- Referuar kategorisë së të rinjve, a ka ndonjë masë ose kërkesë specifike të ndërmarrë nga Bashkia Tiranë? A ka të rinj të rikthyer nga jashtë Shqipërisë së fundmi pas datës 9 Mars? Çfare shërbimi po ju ofrohet atyre?
- Cilat janë mjetet dhe mënyrat që komunikoni me qytetarët në njësi administrative dhe në qytet për shërbimet që ofroni gjatë periudhës së izolimit/vetëkarantinimit të detyrueshëm?

Ne kemi përgatitur disa tabela të vendosura në aneks të kësaj letre që mund të ndihmojë për mbledhjen e informacionit. Për sa më sipër, sipas kategorive do ju luteshim që të na dërgoni statistikat përkatëse dhe mënyrën e funksionimit të ndërmarrjes së masave në këtë kuadër.

Gjithashtu, donim t'ju vinim në dijeni se përpara zgjedhjeve lokale të Qershorit 2020, organizata jonë dhe ju, keni nënshkruar Kontratën Sociale, e cila përmban disa prioritetë të cilat janë informuar në aktivitetet tona nga qytetarët e Tiranës. Ne jemi të bindur që ju keni punuar gjatë 2019 dhe po punoni në 2020 për ti realizuar ato, megjithë fatkeqësitë e mëdha natyrore si tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe COVID-19. Në lidhje me Kontratën Sociale dhe zbatimin e saj ne do të bëjmë një tjetër kërkesë në muajin qershor 2019-të. Informacioni i kërkuar më sipër do të ishte një udhëzues edhe për ne si organizatë për të parë mundësinë se si mund të ofrohemi për ndihmë në këto kohë të vështira dhe të pazakonta për të gjithë.

Edhe pse situata është e vështirë, duhet të kemi parasysh të gjithë që komuniteti e ka të nevojshëm informacionin e saktë, sjelljen me dinjitet kundrejt tyre dhe mbështetjen ekonomiko - sociale.

Duke ju uruar punë të mbarë në menaxhimin dhe përballimin e kësaj fatkeqësie natyrore, mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj,